

VENDIM
Nr. 50, datë 31.7.2013

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN “PËR EKSPORT-IMPORTET E KARTËMONEDHAVE DHE TË MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 34 dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për eksport-importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare”, miratuar me vendimin nr. 39, datë 25.5.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, neni 6 pika 1, ndryshon si më poshtë vijon:

“Eksporti i monedhave shqiptare me kurs ligjor jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm në rastet e mëposhtme:

a) nga personat juridikë për kryerjen e veprimtarive numizmatike;
b) nga kompanitë e printimit të kartëmonedhave dhe monedhave për qëllime studimi ose promovimi të lidhura me shtypjen apo rishtypjen e kartëmonedhave ose monedhave shqiptare me kurs ligjor;

c) nga persona juridikë për adoptim dhe testim të makinerive dhe sistemeve përpunuese, arkëtuese dhe të lëvrimit automatik të kartëmonedhës e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor”.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani